Linda Shahini, lokalet që janë dhënë në shfrytëzim kanë qenë në tender dhe nuk qëndron ajo se këto lokale janë dhënë me influencë politike.

Ramiz Qeriqi, populli e thotë një fjalë se ai që e ka mizën ner kapuq i djegë dhe këtu po i djeg dikujt dhe ka qenë më shumë politike.

Latif Ramadani, u përgjegg duke shtuar se të gjitha lokalet janë dhënë në baza ligjor dhe para se me i qitë në tender kemi kërku sqarime nga ministria dhe në bazë të sqarimeve duke respektuar edhe Ligjin i kemi dhënë lokalet në shfrytëzim.

Sefer Tasholli, Nënkryetar i Komunës, tha se në mandatin e kaluar lokalet janë dhënë në shfrytëzim në mënyrë të paligjshme dhe këtë e din edhe Luli, gjithashtu në mandatin e kaluar janë dhënë në shfrytëzim pronat për 10 vite dhe shfrytëzuesit fare nuk i kanë paguar qira komunës.

Avni Olluri, këto lokale janë dhënë në shfrytëzim me vendim të Kuvendit dhe komisioni ka udhëheqë të gjitha procedurat për dhënien në shfrytëzim të këtyre lokaleve.

Florent Hoxha, e tha edhe Luli që këto lokale janë dhënë në mënyrë jo ligjore dhe Sefa në fillim të mandatit që ka marrë si Nënkryetar ka punuar si hetues. Pastaj tha se me shkëputjen e kontratës lokalet duhet të mbyllen andaj pyes se a janë mbyllë këto lokale.

Sefer Tasholli, për fjalën që u tha se kam punuar si hetues unë nuk kam punuar si hetues por hetuesit kanë punuar dhe kanë kryer punën e tyre.

Blerim Gashi, u tha politike dhe na jemi duke bërë politikë këtu dhe vendimet për dhënien në shfrytëzim të pronave kanë kaluar në Kuvend. Në fund pyeti se si Kuvend a kemi të drejtë me marrë vendime meqë janë shpallur zgjedhjet lokale.

Ali Stublla, komisionet që kanë udhëheqë procedura janë të një anshëm dhe komplet janë të LDK-së.

Vlora Limani-Hajnuni, ky Kuvend ka marrë vendim për formimin e komisionit dhe kur Kuvendi thotë jo një vendimi atëherë duhet të ketë propozim tjetër e jo vetë kur thotë jo.

Ramiz Qeriqi, theksoi se po bëhen pazare me delegat se Avnia foli për komisionin që është formu nga Kuvendi por jo veq komisioni po edhe Avnia si individ për interesa e ka ndërruar edhe partinë. Pastaj tha se unë edhe më herët kur Shukri Buja ka dhënë lokalet apo pronat në shfrytëzim kam thënë se janë dhënë keq e gjithashtu edhe gjatë pushteti të

Imrisë janë dhënë keq këto prona dhe pyes pse Imri Ahmeti nuk i ka zbuluar dhënien e këtyre pronave por sigurisht edhe ky ka qenë i implikuar edhe atëherë edhe tani.

Latif Ramadani, po i përgjigjet Blerimit se me Ligj Kuvendi nuk mund të jep pronën në shfrytëzim afatëgjatë por vetëm me afatshkurtë, ndërsa sa i përket dhënies në shfrytëzim të pronave-lokaleve afariste janë zbatu të gjitha procedurat.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesja vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 15 vota për 9 kundër 1 apstenim qka do të thotë se propozimi i vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtë të pronave të palujtëshme-lokaleve afariste nuk u aprovu.

IV

Propozim Vendim për hartimin e hartës zonale të Komunës së Lipjanit

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Ilir Tasholli, drejtorit, i DPU-se, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i vendimit për hartimin e hartës zonale të komunës së Lipjanit .

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Ali Stublla, pyeti se si ka mundësi që Jeta e Re me u përfshi në hartën zonale si fshat.

Labinot Shahini, ne grupi parlamentar i LDK-së e kemi shqyrtu këtë propozim vendim dhe të njëjtin e përkrahim.

Florent Hoxha, në këtë vendim jemi thirrë në Statut të komunës dhe e dijmë sa zona kadastrale janë dhe konsideroj se ky vendim është në kundërshtim me Statutin e Komunës. Në vazhdim kërkoj që në hartën zonale të përfshihen të gjitha fshatrat.

Ilir Tasholli, u përgjigj në pyetjen e Ali Stublles dhe Florent Hoxhes duke shtuar se për Jetën e Re është thënë disa herë të përfshihen si fshat dhe dihet se kjo nuk është në kompetencën tonë. Në vazhdim tha se komuna e jonë është një ndër komunat e para që ka fillu hartimin e hartës zonale e cila hartë do të zavëndsoj planin urban.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesja vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 21 vota për miratoi këtë:

V E N D I M

PËR HARTIMIN E HARTËS ZONALE TË KOMUNËS SË LIPJANIT

Neni 1

Lloji i dokumentit të planifikimit hapësinor

Me këtë Vendim fillohet hartimi i Hartës Zonale të Komunës së Lipjanit .

Neni 2

Përkufizimi i dokumentit të planifikimit hapësinor

Me këtë Vendim përkufizohet dokumenti i planifikimit hapësinor, Harta Zonale e Komunës në harmoni me ligjin si dokument multi-sektorial që përmes grafikoneve, fotografive, hartave dhe tekstit përcakton hollësisht llojin, destinimin, shfrytëzimin e planifikuar të hapësirës dhe masat e veprimit të cilat bazohen në kohëzgjatje dhe projeksione të arritshme të investimeve publike dhe private për tërë territorin e Komunës së Lipjanit, për periudhën tetë (8) vjeçare.

Neni 3 Qëllimi i hartimit

Me Hartën Zonale të Komunës nga neni 1 i këtij Vendimi, përcaktohen kushtet zhvillimore dhe kushtet ndërtimore për zonat urbane dhe rurale në kontekst të ndryshimeve të bëra dhe harmonizimin e tyre me nevojat reale dhe mundësitë për të arritur kushte optimale të rregullimit dhe ndërtimit në Komunën e Lipjanit, me qëllim të plotësimit të kërkesave ligjore për rregullimin e zhvillimeve në zonën urbane dhe rurale.

Neni 4 Kufiri i territorit

Zonat Kadastrale në territorin e Komunës së Lipjanit të përfshira janë :

Nr.	Zona Kadastrale	Shifra	ha	a	m ²
1	Akllap	71409062	1134	82	53
2	Babush I Muhaxhereve	71409059	515	81	59
3	Banullë	71409003	389	77	55
4	Bregu I zi	71409087	189	33	20
5	Bukovicë	71409009	260	74	53
6	Baicë	71409004	431	84	25
7	Brus	71409007	1153	84	25
8	Blinaje	71409045	1723	14	62
9	Bujan	71409008	224	71	30
10	Qylagë	71409090	308	51	52
11	Divjake	71409024	209	67	69
12	Dobrajë e Madhe	71409012	647	31	40
13	Dobrajë e Vogël	71409049	127	10	62
14	Grackë e vjeter	71409080	473	64	73
15	Grackë e Vogel	71409051	160	70	63
16	Gadime e Ultë	71409028	932	85	24
17	Gumnasellë	71409022	249	10	20
18	Gadime e Epërme	71409020	1963	50	50
19	Glllogoc	71409018	544	11	31
20	Hanroc	71409001	1013	94	84
21	Hallaq I Vogël	71409050	143	90	21
22	Hallaq I Madhë	71409013	408	99	90
23	Janjevë	71409033	1085	59	60
24	Kleçkë	71409034	502	40	99
25	Konjuh	71409036	409	04	14
26	Kraishtë	71409038	983	54	96
27	Kroimir	71409039	944	87	39
28	Okosnicë	71409063	549	76	77
29	Kojskë	71409035	228	75	51
30	Leletiq	71409040	399	54	77
31	Lipjan	71409044	946	38	94
32	Llugë	71409046	176	97	04

33	LLugaxhi	71409047	336	47	21
34	Marec	71409054	299	35	09
35	Medvec	71409055	362	96	47
36	magure	7149048	326	65	69
37	Mirenë	71409057	587	41	49
38	Poturovc	71409067	315	55	53
39	Plitkoviç	71409050	530	97	39
40	Resinoc	71409073	575	86	55
41	Ribar I Vogël	71409052	199	15	87
42	Ribar I madhë	71409014	1162	89	65
43	Rubovc	71409068	692	67	85
44	Rufc I Ri	71409061	290	82	68
45	Rufc I Vjetër	71409081	290	54	32
46	Silovi	71409077	2265	97	70
47	Smallushe	71409078	861	24	58
48	Shalë	71409075	1076	09	76
49	Shisharkë	71409092	414	10	07
50	Teqe	71409083	111	22	53
51	Topliqan	71409085	744	33	04
52	Torinë	71409086	139	40	22
53	Vrellë e Gadimes	71409011	259	54	52
54	Vrellë e Goleshit	71409016	1192	97	92
55	Vershec	71409017	590	00	01
56	Vogaqicë	71409010	508	97	94
57	Varigoc	71409011	186	04	81
58	Zllakuqan	71409032	113	22	31
Gjithsej			33864	09	11

Neni 5

Subjekti përgjegjës për hartim

Bartës i procesit të hartimit të Hartës Zonale të Komunës është Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Neni 6

Mjetet dhe mekanizmat e nevojshëm për hartim

Mjetet për hartimin e Hartës Zonale të Komunës sigurohen nga buxheti i Komunes së Lipjanit dhe GIZ FPHMT, në formë të bashkëfinancimit të definuara në Memorandumin e Mirëkuptimit.

Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit në bashkepunim me autoritetet përgjegjëse nga GIZ FPHMT koordinon procesin e hartimit të Hartës Zonale me drejtoratet sektoriale, dhe burimet njerëzore brenda Komunës si dhe Kompaninë konsulente.

Dokumenti i planifikimit – Harta Zonale e Komunës hartohet në bashkepunim me GIZ FHPMT në bazë të Memorandumit të Mirëkuptimit në mes të Komunës së Lipjanit dhe Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ) në kuadër të projektit për

Fuqizim të Planifikimit Hapësinor dhe Menaxhimit të tokës (FPHMT) të financuar nga Ministria Federale e Gjermanisë për Zhvillim dhe Bashkepunim si dhe Kompanisë konsulente të perzgjedhur përmes procedurave të prokurimit publik sipas Ligjit Nr. 03/L-241 Për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës.

Neni 7 **Afati i hartimit**

Bartësi i hartimit të dokumentit të planifikimit hapësinor sipas nenit 1 të këtij Vendimi është i obliguar që Hartën Zonale të Komunës ta hartojë në afat prej 15 muajve që nenkupton kompletimin e dokumentit për prezantim në procesin e konsultimeve publike, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi.

Neni 8 **Konsultimet Publike**

Projekti i Hartës Zonale të Komunës para finalizimit duhet të vihet në konsultime publike dhe në shqyrtim publik. Paraqitja e Projekt-Hartës Zonale të Komunës në shqyrtim publik dhe koha për dhënien e Vërejtjeve dhe komenteve do të shpallen përmes njoftimeve publike.

Neni 9 **Afati i Vlefshmërisë**

Harta Zonale e Komunës hartohet për periudhën kohore 8 (tetë) vjeçare

Neni 10 **Gjuha zyrtare**

Dokumenti i planifikimit hapësinor sipas nenit 1 të këtij vendimi duhet të jete në gjuhët zyrtare të komunës dhe së paku në 3 (kopje) të shtypura e të vulosura dhe 3 kopje digjitale të origjinalit.

Neni 11 **Programi**

Pjesë e këtij vendimi është programi për hartimin dhe menaxhimin e procesit të planifikimit i paraparë me nenin 11 pika 1.3. të Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174.

Neni 12 **Hyrja në fuqi**

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të Ministrisë së Administrimit të pushtetit lokal dhe publikimit në Webfaqen e Komunës.

Shtesë: Vendimi.

V

Propozim Vendim për hartimin e projektit të strategjisë për zhvillim ekonomik lokal të Komunës së Lipjanit për periudhën 2018-2023

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Latif Ramadani, drejtorit, i DEZH, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i vendimit.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Agron Hajdini, na e dëgjua arsyetimin e vendimit që e dha drejtori dhe grupi parlamentar i LDK-së e përkrahu këtë vendim.

Florent Hoxha, e kemi shqyrtu këtë propozim Vendim dhe e dijmë se cilat procedura duhet të zbatohen për hartimin e strategjisë. Në vazhdim tha se pyes drejtorin se cilat programe janë marr nga strategjia e zhvillimit ekonomik që ka qenë në fuqi dhe cilët janë indikatorët matës deri ku është arritë me strategjin e viteve 2012-2017. Në fund tha se ne si grup parlamentar e përkrahim këtë propozim vendim.

Latif Ramadani, është e vërtetë se ky është një dokument bazë por krahas kësaj është edhe plani zhvillimor urban dhe komuna gjerë më tani ka punuar në bazë të këtyre dy planeve.

Meqë diskutime tjera nuk pati rreth kësaj pike, Kryesuesja Vlora Limani-Hajnuni vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 23 vota për asnjë kundër dhe asnjë apstenim miratoi këtë:

VENDIM

PËR HARTIMIN E PROJEKTIT TË STRATEGJISË PËR ZHVILLIM EKONOMIK LOKAL TË KOMUNËS SË LIPJANIT PËR PERIUDHËN 2018-2023

Neni 1

TË HARTOHET, Projekti i Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal të Komunës së Lipjanit, për periudhën 2018-2023.

Neni 2

Qëllimi i hartimit të projekt-dokumentit të Strategjisë për Zhvillimin Ekonomik Lokal të Komunës së Lipjanit është definimi i prioriteteve të ardhëshme strategjike, ndërtimit të kapaciteteve të institucioneve lokale dhe resurset njerëzore për planifikim dhe drejtim të zhvillimit ekonomik lokal.

Fillimi i procedurave për hartimin e këtij dokumenti bëhet duke u bazuar në faktin se Strategjia paraprake e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2012-2017, e aprovuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës 15Nr.06-22/1 i datës 27.12.2011, është hartuar për periudhë pesëvjeqare 2012-2017, çka nënkupton se janë plotësuar kushtet ligjore edhe në pikëpamje të kohës për hartimin e Projektit të Strategjisë së re të Zhvillimit Ekonomik lokal të Komunës .

Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal përfaqëson një nga shtyllat kryesore të Strategjisë Zhvillimore Komunale, kështu që në përputhje me këtë duhet të përmbajë: qëllimet strategjike, objektivat, programet dhe ndërhyrjet tjera konkrete që shërbejnë për arritjen e vizionit të Komunës.

Neni 3

Bartës i procesit të hartimit të dokumentit të Strategjisë deri në finalizim do të jetë Komisioni Komunal i cili do të formohet me Vendim nga Kryetari i Komunës i cili do të ketë prej 7 deri një 11 anëtar në përbërjen e të cilit do të angazhohen edhe ekspertë të jashtëm.

Komisioni është i obligur që në afatin prej 6 muajsh të harton Projektin e Strategjisë së zhvillimit ekonomik lokal .

Punët administrative teknike për Komisionin do t'i kryej Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim në bashkëpunim me Drejtoratin për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Neni 4

Projekti i Strategjisë e Zhvillimit Ekonomik duhet të vëhet në shqyrtim publik dhe Webfaqen e Komunës për komente. Paraqitja e dokumentit SZHEL në shqyrtimin publik dhe koha për dhënien e shqyrtimeve dhe komenteve do të shpallen në mjetet e informimit.

Neni 5

Mjetet për hartimin e dokumentit sigurohen nga buxheti i Komunës, që rezulton me procedurat e përgjithshme të cilat rezultojnë me mbështetje financiare për punën e Komisionit, përgatitjen teknike dhe përfundimisht botimi i dokumentit dhe publikimi.

Neni 6

Dokumenti i Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik hartohet për periudhën 5 vjeqare.

Neni 7

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të Ministrisë së Administrimit të pushtetit lokal dhe publikimit në Webfaqen e Komunës

Shtesë: Vendimi.

VI

Propozim Vendim për miratimin e planit për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore të Komunës së Lipjanit 2017-2020

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Basri Hashani, drejtor i DKRS, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i vendimit.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Nehat Tërpeza, unë e përkrahu komisionin që ka hartuar këtë plan e gjithashtu edhe grupi parlamentar i LDK-së e ka shqyrtu dhe e përkrahë këtë plan.

Florent Hoxha, na e kemi shqyrtu këtë plan edhe pse është mjaft voluminoz na kemi vërejtjet tona se në këtë plan nuk është paraqitë kostoja e realizimit të tij. Pastaj në plan thuhet rreth 57 mijë banorë unë mendoj se duhet të thuhet saktë se sa banor janë. Gjithashtu për qytetin e Lipjanit thuhet 10 mijë banorë a sipas statistikave thuhet sakt se Lipjani ka 6 mijë banorë. Pastaj tha se në plan është dashtë të qiten fusnotat se nga janë marrë shënimet. Në vazhdim kërkoi që në këtë plan duhet të përfshihen edhe shumë

qështje tjera siqë janë lartësia mbidetare, monomentet e ndryshme historike që kanë mbetur pa u përfshi, objekte të vjetra, drunjë të ndryshëm etj.

Ramiz Qeriqi, propozoj që ky plan të shtyhet në mënyrë që të plotësohet me disa të dhëna të cilat nuk janë përfshi nga lufta e lavdishme e UÇK-së.

Agron Hajdini, ne jemi për miratimin e këtij plani por në vazhdimësi ky plan mundet me u plotësu nga komisioni po për momentit duhet ta kemi këtë plan.

Basri Hashani, ky nuk është plan përfundimtar dhe ka mundësi që të plotësohet me ato që i tha Florenti dhe ne do t'i nxjerrim nga inqizimi i mbledhjes dhe do ta plotësojmë.

Te parku industrial nuk e dhatë përgjigjen se sa hektar janë.

Basri Hashani, unë nuk e di sakt por vendimi i fundit i Kuvendit është 56 hektar.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesja vuri në votim propozimin e vendimit me ndryshimet që në plan të përfshihet parku industrial me 56 ha si dhe pllakat historike në Krojmir dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 22 vota për 1 apstenim asnjë kundër miratoi këtë:

VENDIM
PËR MIRATIMIN E PLANIT PËR MBROJTJEN E TRASHËGIMISË KULTURORE DHE
NATYRORE TË KOMUNËS SË LIPJANIT 2017-2020

Neni 1

MIRATOHET , Plani për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore të Komunës së Lipjanit 2017-2020.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Plani për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore të Komunës së Lipjanit 2017-2020.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedist dhe Drejtorati për Inspeksion.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokolit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe publikimit në Webfaqen e Komunës .

Shtesë: Vendim.

VII

Propozim Vendim për themelimin e dy (2) vendgjuetive të përbashkëta në territorin e komunës së Lipjanit.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Feti Krasniqit drejtor i DBPZHR, i cili në vazhdim njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i vendimit.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Burbuqe Fazliu, na si grup parlamentar i LDK-së e kemi shqyrtu këtë propozim vendim dhe të njejtin e përkrahim.

Enver Kozhani, edhe ne si grup parlamentar i PDK-se e përkrahim këtë propozim vendim.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesja vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 23 vota për miratoi këtë:

VENDIM
PËR THEMELIMIN E DY (2) VENDGJUETIVE TË PËRBASHKËTA NË
TERRITORIN E KOMUNËS SË LIPJANIT.

Neni 1

Me qëllim të shfrytëzimit ekonomik të resurseve në mbrojtjen adekuate të kafshëve të egra si dhe për sigurinë dhe standardin e etikës së gjahtarëve, me këtë Vendim themelohen dhe përcaktohen sipërfaqet e dy vendgjuetive të përbashkëta në territorin e komunës së Lipjanit.

Neni.2

Vendgjuetitë e përbashkëta do të mbajnë emrin: Vendgjuetia e përbashkët “LIPJANI LINDJE” dhe “LIPJANI PËRËNDIM”

- a. Vendgjuetia e përbashkët “LIPJANI LINDJE”, me sipërfaqe gjuetie prej 11677.73 ha, dhe me sipërfaqe të përgjithshme brenda kufijve të vendgjuetisë prej 13358.73 ha,
- b. Vendgjuetia e përbashkët “LIPJANI PËRËNDIM”, me sipërfaqe gjuetie prej 12146.29 ha dhe me sipërfaqe të përgjithshme Brenda kufijve të vendgjuetisë prej 19987.21 ha.

Neni 3

Vendgjuetia e përbashkët “Lipjani lindje” përcaktohet në hapsirën e përbërë nga pronësia publike dhe private e cila përkufizohet si vijon:

Linja kufitare e vendgjuetisë së përbashkët “Lipjani-lindje” kufizohet me: Autostradën “Arbër Xhaferi” duke filluar nga fshati Dobratin, Kumuna Graqanicë për të vazhduar përgjatë saj deri në fshatin Babush i Muhaxherëve. Vazhdon përgjatë kufirit administrativ me Komunën e Ferizajit dhe Zonës kadastrale të fshatit Babush i Muhaxherëve që lidhet në vazhdim me zonën kadastrale Gadime e Ulët dhe Gadime e Epërme. Vazhdojnë Zonat Kadastrale: Vrellë e Gadimes, Plitkoviqit, Sllovisë, Akllapit, Vogaqicës dhe Brusit përgjatë kufirit administrativ me Komunën e Gjilanit. Zona kadastrale e Brusit vazhdon përgjatë kufirit administrativ me Komunën e Novo Bërdës dhe Komunës së Prishtinës. Pas saj vjen Zona kadastrale e Hanrovcit e cila kufizohet me kufijt administrative të Komunës së Prishtinës kurse Zona Kadastrale e Okosnices kufizohet me Kufijt administrativ te Komunas së Prishtinës dhe Graqanicës. Zona Kadastrale e Janjevës kufizohet me kufijt administrative te komunes së Prishtinës për të vazhduar me Zonën Kadastrale të Teqes e cila kufizohet me kufijt administativ të Komunes së Prishtinës dhe Graqanicës. Vazhdojnë Zonat Kadastrale të

Janjevës, Akllapit, Sllavisë dhe Smallushës të cilat kufizohen me kufijt administrative të Komunes së Graqanicës e cila bashkohet me pikën fillestare në Autostradën “Arbër Xhaferi”.

Neni 4

Vendgjuetia e përbashkët “Lipjani perëndim” përcaktohet në hapsirën e përbërë nga pronësia publike dhe private e cila përkufizohet si vijon:

Linja kufitare e vendgjuetisë së përbashkët “Lipjani-perëndim” kufizohet:

Fillon përgjatë kufirit administrativ të Komunës së Graqanicës me Zonat kadastrale: Livagjë dhe Gushtericë e poshtme për të vazhduar përgjatë Autostradës “Arbër Xhaferi” deri në fshatin Babush i Muhaxherëve. Vazhdon përgjatë kufirit administrativ me Komunën e Ferizajit dhe Zonës kadastral të fshatit Babush i serbëve që lidhet në vazhdim me zonën kadastrale Bablak dhe Tërn. Vazhdon përgjatë kufirit administrativ me Komunën e Shtimes me Zonat kadastrale: Vojnovc, Muzeqinë, Gjurovc, Godanc i Epërm, Zborc, Pjetërshticë dhe Karaqicë. Vazhdon përgjatë kufirit administrativ me Komunën e Suharekës me Zonën kadastrale të Javorit. Vazhdon përgjatë kufirit administrativ të Komunës së Malishëvës me Zonat kadastrale: Lladroc, Senikë, Lladroviq dhe Tërpezë. Tutje kufizohet përgjatë kufirit administrativ të Komunës së Glllogocit me Zonat kadastrale: Nekocë, Fushticë e Poshtme, Fushticë e Epërme dhe Sankoc. Vazhdon përgjatë kufirit administrativ të Komunës së Fushë Kosovës me zonat kadastrale: Harilaq, Sllatinë e Madhe dhe Hencë. Vazhdon përgjatë kufirit Administrativ të Komunës së Graqanicës me Zonat Kadastrale: Radevë, Lepi, Skallanë dhe përfundon më Zonën kadastrale të Suhadollit për t`u bashkuar me pikën fillestare.

Neni 5

Në vendgjuetitë e përbashkëta në sipërfaqet në vijim ndalohet gjuetia: në zonat e mbrojtura të natyrës, tokave brenda 300 m nga vendbanimet, rrugët kryesore publike, ndërtesat dhe objektet të përcaktuara në nenin 24 të Ligjit për gjuetinë.

Neni 6

Vendgjuetitë e përbashkëta të përcaktuara me këtë Vendim do të ipen personave fizik ose juridik në menagjim përmes koncesionit ose dhënjes me qera duke zbatuar procedurat e tenderimit përkatësisht ofertuesit publik konform dispozitave ligjore.

Neni 7

Përkritazi me dhënjen në menagjim me qera të vendgjuetive të përbashkëta Komuna dhe ofertuesi do të lidhin kontratë e cila do të përmbajë elementet e parapara të Nenit. 36, 37, 38 në kohëzgjatje të shfrytëzimit të vendgjuetisë jo më tepër se 10 vite.

Neni 8

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të Ministrisë së Administrimit të pushtetit lokal dhe publikimit në Webfaqen e Komunës.

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi i Kuvendit të Komunës për themelimin e vendgjuetisë së përbashkët në territorin e Komunës së Lipjanit 1Nr.464-605 i datës 07.05.2009.

Shtesë: Vendimi.

VIII

Raporti i buxhetit dhe shpenzimi në bazë të burimit të mjeteve kategorive ekonomike dhe programeve Janar-Qershor 2017 për Komunën e Lipjanit.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Shkelzen Hajdini, drejtor i DBF-së i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Agron Hajdini, ne e dëgjuam drejtorin dhe e kemi pasur materialin dhe sipas materialit shihet se buxheti për periudhën 6 muajorë është realizuar me 69%, por te prokurimi dhe te shërbimet publike realizimi është i ulët.

Florent Hoxha, të hyrat vetanake për 6 muajorë nuk janë paraqitur por vetëm shpenzimet. Në vazhdim tha se nga mjetet e qeverisë duhet të kemi kujdes se nëse nuk i realizojmë deri në fund të vitit këto mjete mund të kthehen në qeveri. Në vund tha se është mirë që t'u përmbahemi planeve që kanë drejtorit në mënyrë që buxheti të realizohet.

Meqë diskutime tjera nuk pati rreth kësaj pike Kryesuesja vuri në votim raportin e shpenzimeve dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 10 vota për 8 kundër

Aprovoi

Raportin e buxhetit dhe shpenzimeve në bazë të burimit të mjeteve kategorive ekonomike dhe programeve Janar-Qershor 2017 për Komunën e Lipjanit.

Pasi qështje tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 14,³⁵

***Ekstraktin e hartoi
Sami Murati***

***Kryesuesja e Kuvendit
Vlora Limani-Hajnuni***